

Ky raport analizon transparencën dhe financimin e subjekteve politike në Kosovë duke u bazuar në legjislacion dhe zbatimin të tij në praktikë.

Gjashtë pjesët kryesore të këtij raporti mbulojnë transparencën, raportimin, monitorimin, zbatimin e ligjit dhe rregulloreve, dënimet dhe çështje të tjera të cilat lidhen me ndershmërinë e financimit.

Raporti analizon çështjet e financimeve publike nga buxheti i shtetit dhe kontributeve nga donatorët e subjekteve politike.

Sa i përket transparencës, e përbashkëta e të gjitha partive politike parlamentare është se ato nuk i publikojnë raportet e veta financiare. Përgjithësisht në transparencë financiare bënë vetëm Lëvizja Vetëvendosje, e cila i ka të publikuara këto raporte në ueb faqen e saj. Për më tepër dy partnerët e koalicionit qeverisës PDK dhe LDK të cilat së bashku marrin mbi dy milionë euro në vit nga buxheti i shtetit, nuk kanë ueb faqe funksionale. Kuvendi i Kosovës, që kur është amendamentuar Ligji për Financimin e Subjekteve Politike në vitin 2013 ka dështuar të përzgjedh auditorët për të audituar financimin e subjekteve politike. Kjo ka ngritur pikëpyetjen nëse ky institucion ka fare për qëllim që të bëjë këtë përzgjedhje.

Vet ideja që Kuvendi i cili përbëhet nga deputetët që janë drejtpërdrejtë rezultat i proceseve zgjedhore, të bëjë përzgjedhjen për të audituar financat e subjekteve politike është e gabuar.

Kjo pasi që deputetët para interesit publik, rrezikojnë t'i vendosin interesat e subjekteve të tyre apo edhe ato personale. Përveç çështjeve të tjera, është gjithashtu vitale përzgjedhja e institucionit i cili do të jetë përgjegjës që të zbatojë Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike. Ky institucion përveç se shpërndan fondet është edhe i mandatuar të kontrollojë zbatimin e ligjit dhe në rast të shkeljeve të shqiptojë dënime për subjektet të cilat veprojnë në kundërshtim me ligjin.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), përbëhet nga anëtarë të cilët përfaqësojnë subjektet më të mëdha 3 Sa kushton demokracia? politike në Kosovë. Si i tillë ky institucion nuk e ka pavarësinë e duhur për të mbikëqyrur me pa anësi dhe për të detyruar subjektet që të respektojnë të gjitha kërkesat ligjore.

Për më tepër edhe nëse KQZ do të kishte vullnetin e mirë për të mbikëqyrur zbatimin e këtij ligji, ky institucion nuk ka kapacitete mbikëqyrëse dhe hetuese.